Kronikë

Vritet me një plumb në kokë 48-vjeçari në Kavajë, u qëllua në lokal teksa ishte me babanë! Dyshohet për hakmarrje, vëllai i viktimës u vra në mars pas një konflikti banal

*48-vjeçari Arjan Gosa është vrarë në Kavajë. Arjan Gosa është qëlluar me një plumb në kokë teksa ka qenë duke pirë kafe me babanë e tij në një lokal në Kavajë. **Autori ende i paidentifikuar**. Shkak i vrasjes dyshohet hakmarrja, pasi më 29 mars ndodhi një vrasje e dyfishtë, ku pas një sherri banal vdiqën Edmond Gosa dhe Altin Rexha.*

- Vrasja në Kavajë, del EMRI, ja kush është 48-vjeçari që u qëllua me armë në lokal
- Vrasja në Kavajë, Report Tv sjell pamjet! Në vendin e ngjarjes edhe i ati i viktimës
- Vrasja në Kavajë, Policia: Dyshohet për hakmarrje, autori ende i paidentifikuar
- Vrasja në Kavajë, mbërrin në vendin e ngjarjes FNSH-ja

Redaksia
21 Maj, 18:35 | **Përditesimi: 21 Maj, 20:25**

KAVAJË- Një vrasje e dyfishtë për një konflikt banal që ndodhi në muajin mars të këtij viti, solli edhe një tjetër viktimë për shkak përplasjes mes dy fiseve Gosa dhe Rexha. 48-vjeçari Arian Gosa u qëllua për vdekje ditën e sotme me armë zjarri në Kavajë. Shkak i vrasjes dyshohet se është hakmarrja, pasi më 29 mars ndodhi një vrasje e dyfishtë, ku pas një sherri banal vdiqën Edmond Gosa, vëllai i Arjan Gosës, dhe Altin Rexha.

Gazetari i Report Tv, Sokol Dema ka mësuar se një plumb në kokë i ka marrë jetën Arian Gosës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 18.30, në lagjen Nr. 1, në Kavajë, teksa Gosa ka qenë i ulur në lokal duke pirë kafe me babanë e tij. Një person është afruar dhe e ka qëlluar me një plumb në kokë, i cili ishte fatal dhe i mori jetën 48-vjeçarit. Report Tv ka siguruar edhe foto nga vendi i ngjarjes, ku viktima dallohet ende në tavolinën ku u vra. Report Tv ka mësuar se babai i 48-vjeçarit është shoqëruar në polici, por ai nuk ka folur përpara uniformave blu.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Iu ndryshuan dy elementë, rikonstruksioni i mozaikut në ballë të Muzeut Historik nxit debat mes ekspertëve

Shkak i vrasjes paraprakisht dyshohet të jetë hakmarrja, e ndërsa dyshimet bien mbi fisin Rexha si porositës të atentatit. Pas vrasjes autori është larguar në këmbë, ndërsa deri më tani nuk ka ende asnjë gjurmë prej tij. Policia dhe grupi hetimor janë në vendngjarje dhe kanë ngritur pika kontrolli për të bërë të mundur kapjen e autorit.

Ende nuk dihet nëse autori pas ka ikur me këmbë është ndihmuar apo jo nga persona të tjerë për t'u larguar nga zona e Kavajës. Grupi hetimor do të vëzhgojë kamerat e sigurisë në zonë, si edhe ato të lokalit ku ndodhi vrasja, të cilat mund të çojnë në gjurmët e autorit.

Si ndodhi vrasja e Edmond Gosës dhe Altin Rexhës më 29 mars?
Një konflikt banal më 29 mars të këtij viti çoi në ***vrasjen*** e Edmond Gosës, alias Armand Gosa, dhe Altin Rexhës, alias Sali Rexha, në Kavajë. Ata kanë pasur një konflikt disa ditë më parë dhe më 29 mars ata u takuan rastësisht në një lokal, ku teksa u përpoqën të sqaronin sherrin, situata degradoi deri në vrasje.

Pyetja '***Pse më sheh ashtu***' nga Edmon Grosa ka irrituar Altin Rexhës, i cili ka marrë thikën dhe ka plagosur Edmond Grosën. Më pas ky i fundit i është kundërpërgjigjur me armë, duke e lënë të vdekur Altin Rexhën, por edhe vetë Edmond Grosa humbi jetën nga plagët që mori nga plagosja me thikë. Fisi Gosa mbahen edhe si "të fortët" në Kavajë. Në momentin që Gosa ka qëlluar me armë, në vend ngjarje ka qenë edhe fëmija i Altin Rexhës, i cili ishte futur në një dyqan.

E shkuara kriminale e Armand dhe Arian Grosës
Armand Gosa nuk ishte figurë e panjohur për drejtësinë pasi ishte përfshirë edhe më parë në një ngjarje kriminale. 10 vite më parë po në qytetin e Kavajës, së bashku me vëllain e tij Arjanin, i cili mbeti i vrarë sot, masakruan me thika një person në vitin 2012. Viktima Gentjan Gjuzi humbi jetën pak muaj më vonë në spitalin e neurokirurgjisë. Sherri në atë kohë lindi për një vajzë. dhe solli për pasojë humbjen e jetës së babait të dy fëmijëve, 41-vjeçarit Mentor alias Gentjan Gjuzi.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Emond Gosa dhe Altin Rexha, mbetën të vrarë më 29 mars

Foto, Viktima Arian Gosa në vendin e ngjarjes

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:36

Vrasja në Kavajë, mbërrin në vendin e ngjarjes FNSH-ja

Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë kanë mbërritur në Kavajë pas vrasjes së 48-vjeçarit Arian Gosa. Report Tv sjell video nga vendi i ngjarjes.

Ora 19:26

Vrasja në Kavajë, Report Tv sjell pamjet! Në vendin e ngjarjes edhe i ati i viktimës

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes në Kavajë, ku mbeti i varrë 48-vjeçari Arjan Gosa. Ai u qëllua me një plumb në kokë. Në vendin e ngjarjes dallohet edhe i ati i viktimës

Ora 18:59

DETAJE nga vrasja në Kavajë, 1 plumb në kokë i mori jetën 48-vjeçarit, ishte në lokal me babanë

Një plumb në kokë i ka marrë jetën Arjan Gosës, 48-vjeç. Gosa ishte duke pirë kafe në një lokal në Kavajë, kur një person është afruar dhe e ka qëlluar me një plumb në kokë. Fatkeqësisht plumbi i mori jetën. I pranishëm ka qenë edhe babai i tij.

Ora 18:53

Vrasja në Kavajë, Policia: Dyshohet për hakmarrje, autori ende i paidentifikuar

Policia ka reaguar për vrasjen e Arjan Gosës në Kavajë. Policia thotë s epo punon për identifikimin dhe kapjen e autorit. Shkak i vrasjes dyshohet se është hakmarrja, pasu në mars të kërij viti, Arjan Gosës iu vra i vëllai, për shkak të një konflikti banal. Dy persona mbetën të varrë, mes tyre edhe Edmon Gosa.

> *"Më datë 21.05.2023, rreth orës 18.30, në lagjen Nr. 1, në Kavajë, në një lokal, një person ende i paidentifikuar ka vrarë me armë zjarri pistoletë shtetasin A. G.*
>
> *Shërbimet e Policisë pas marrjes së njoftimit kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, kanë rrethuar zonën, kanë ngritur pika kontrolli dhe vijon krehja e zonës për të bërë të mundur kapjen e autorit.*
>
> *Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë ndodhet në vendngjarje dhe vijon veprimet hetimore për sekuestrimin e provave me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit.*
>
> *Paraprakisht nga të dhënat e grumbulluara dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive hakmarrje", njofton policia.*

Ora 18:51

Vrasja në Kavajë, dyshohet për hakmarrje! Vëllai i viktimës u vra në muajin mars pas një konflikti banal

Arjan Gosa mbeti i vrarë ditën e sotme në Kavajë pasi një person e qëlloi me armë zjarri. Shkak i vrasjes dyshihet se është hakmarrja, pasi i vëllai i tij, ***Edmond Gosa u vra*** në muajin mars të këtij viti gjatë një konflikti banal me një person në zonë. Në muajin mars mbetën të vararë Edmond Gosa nga Kavaja dhe Altin Rexha. Por si ndodhi ngjarja?

Gosa që ka plagosur fillimisht me thikë Rexhën dhe më pas ky i fundit i është kundërpërgjigjur me armë. Altin Rexha i cili ka ndryshuar emrin në Sali Rexha, ka qenë me një fëmijë përdore në momentin e konfliktit. Gjithashtu edhe Edmond Gosa e ka ndryshuar emrin në Armand Gosa, teksa fisi i tij mbahet si "të fortët" në Kavajë. Ky i fundit, njihet si person problematik në qytet, i dënuar më parë për plagosjen e rëndë të Gent Gjuzit me kazëm, i cili vdiq më pas në spital. Ngjarja ndodhi pas një konflikti të nisur më parë, ndërsa më 29 mars janë takuar "për t'u sqaruar".

"Pse me sheh ashtu", e pyeti ***Armand Gosa*** personin me të cilin sa herë takohej e thoshte 'malok ikni nga keni ardhur'. Tjetri ishte Sali Rexha, që mesa duket donte t'i jepte fund fyerjeve, dhe e sulmon me thikë. Gosa i njohur si pjesëtar i një fisi të fortë në Kavajë, nxori pistoletën dhe shtiu me Rexhën, fëmija e të cilit vetëm pak minuta më parë ishte futur në dyqan. Të dy vdiqën në vend. Fqinja e Rexhës tregoi momentin, kur djali pa të atin të gjakosur në mes të rrugës.

Gosa nga Kavaja nuk dihet pse kishte inate me Rexhën nga Kukësi. Dhe sipas tij asnjë verior nuk kishte punë në Kavajë. Më 29 maj pasdite të dy u takuan rastësisht në një lokal. Mjaftuan vetëm 3 minuta që debati të përfundonte tragjikisht. Pranë lokalit Saliu kishte shtëpinë me qira, kurse Gosa nuk jetonte fare aty.

Të dy viktimat rezultojnë me precedent penal, kavajasi Gosa për vrasjen e Genti Gjuzit disa vite më parë pasi e goditi me kazmë në sherrin që nisi për një vajzë.

Ora 18:45

Vrasja në Kavajë, del EMRI, ja kush është 48-vjeçari që u qëllua me armë në lokal

Arjan Gosa, 48 vjeç është personi i cili mbeti i vrarë ditën e sotme në Kavajë. Ai u qëllua me armë zjarri teksa ishte në lokal.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Edmond Gosa | Altin Rexha | Arian Gosa | kavaje | vrasje | Tirane

Komento

Komente

Beni: 21/05/2023 20:16

Respekt per paksimin e plerave kudo ne shqiperi, tirane vlore shkoder korce berat lushnje kavaje fier tepelene kukes tropoje lezhe e sarande, Mos te ket me idiote te forte qe skane mbush barkun me buke dhe behen te forte si hajdute, me pase quhen kriminele dhe ne fund biznesmen!

Përgjigju

Scutari: 21/05/2023 19:32

Edhe i vdekur Berisha ka për t'a lënë litarin jashtë!! Nuk kam qenë kundër shpërnguljes së njerëzve nga zonat e thella malore, jam kundër sjelljes së tyre në komunitet dhe ndaj pronës së tjetrit! Toka djerrë duhet të blihej, qoftë edhe një lek metri katror, por ama duhet të blihej dhe shteti të ishte rregullatori, sepse që në momentin e zaptimit lindi konflikti që evoluoi deri në firmat e sotme të këtij krimi!

Përgjigju

Gjin Deda: 21/05/2023 19:11

Rrnofsh Baba Sali q na solle ne Tiran, jena per tok te xanun, malokt jan te paret

Përgjigju

Don Xhon: 21/05/2023 19:11

Nese eshte e vertete sa eshte raportur ne media mbi rastin, ne raste te tilla thuhet "I lumte pushka". Gjynah viktima nese eshte njeri i mire e nuk kishte lidhje me fisin, por duke lexuar ne media thuhet se jane fis te fortesh. E kur eshte, pak a shume, te gjithe jane pjestare e fisit jane te se njejtes kategori. Mos harroni se viktima e ngjarjes se pare, ai tipi nga Kukesi, kishte shkuar per sqarim ishte me femije per dore, shenje e qarte qe nuk kishte shkuar per sherr por per te mbyllur konfliktin.

Përgjigju

Eri: 21/05/2023 19:44

Po me femije me vete dhe pistolete ne brez sic i ka hije nje maloku te pabese. Njerez shpellar te zbritur nga mali nuk behen njerez

Tosi: 21/05/2023 18:57

Pse si kujtuan do ta mbyllin kuksianet me kaq?? Vrau nje njeri te pa fajshem vellai tij

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni propozimin e Berishës për votim të detyrueshëm?

I drejtë | I gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera



Vdekja e Jani Rustemajt pas arrestimit për vjedhje, burime nga AMP: Ende s'janë gjetur shkelje! Nëna e 27-vjeçarit për Report Tv: Djalin ma kanë dhunuar

Sokol Dema

21 Maj, 15:39

Hiqej si zyrtar i lartë dhe mashtronte biznesmenët në Tiranë duke u marrë para, Report TV siguron foto të Florian Gjergjit

Sokol Dema

21 Maj, 14:04

KQZ miraton rezultatin e zgjedhjeve vendore për bashkitë e Tiranës dhe Durrësit

21 Maj, 12:47

Fenomeni i aksidenteve në vende pune, eksperti në Report Tv: Shkak masat që duhet të ndërmerren por edhe neglizhenca e punëtorëve

21 Maj, 12:45

Rama ndan fotot nga Piramida, mijëra qytetarë në godinën e transformuar

21 Maj, 12:11

Vdekja e të riut pas një muaji në koma në QSUT, reagon Berisha: Krim shtetëror, Jani Rustemaj u dhunua nga banditë me uniformë në paraburgim

21 Maj, 12:04

Projekti Thumanë-Kashar u prek pronat, banorët e Bërxullës sërish në protestë: Nuk pranojmë teka të sekserëve, duam shpronësime me çmim tregu

21 Maj, 10:55

Tiranë, ra nga lartësia teksa po punonte në një pallat në ndërtim, ndërron jetë 50-vjeçari

21 Maj, 09:30

Zgjedhjet vendore të 14 Majit, KQZ miraton rezultatin në Tiranë dhe Durrës! 'Certifikohen' fitoret e Erion Veliajt dhe Emiriana Sakos

21 Maj, 08:57

Kongres për paqen në Tiranë: Edukimi, çelësi për ta arritur! Pjesëmarrës nga e gjithë bota: U mahnitëm në Shqipëri

Ledina Jakimi

20 Maj, 18:46

U arrestua për vjedhjen e tapetit dhe një palë atleteje e përfundoi në koma, ndërron jetë 27-vjeçari Jani Rustemaj

20 Maj, 16:52

Organizohet Parada e Krenarisë në Tiranë, parulla që shpalos Komuniteti LGBTQIA+: Hape zemrën! Kërkojnë shërbime për ndërrimin e gjinisë

20 Maj, 16:37

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje